



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtruesi  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavve

A nr. 169/2012

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtruesi (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Xhevdet Abazi kryesues, Nehat Idrizi dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), dega në Kaçanik, paraqitur kundër subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), dega në Kaçanik, për shkak të vendosjes se panos në vendet publike, për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar në Komunën e Kaçanikut, në seancën e panelit të mbajtur me 14.06.2012, mori këtë:

#### VENDIM

**Miratohet** si e bazuar ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosja (LVV), dega në Kaçanik, kështu që subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), dega në Kaçanik i shqiptohet dënim i më gjobë në vlerë prej 2000 (dymijë) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e pranimit të këtij vendimi.

#### Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 11.06.2012, nga subjekti politik LVV, me të cilën pretendohet se militantë të subjektit politik AAK, më datën 11.06.2012, në orën 14:00, në Kaçanik në rrugën “Agim Bajrami”, kanë vendosur panon e kandidatit të tyre për kryetar të Kaçanikut, Tahir Çaka në kala të qytetit. Parashtruesi i ankesës thekson se është bëre shkelje e Rregullës Zgjedhore Nr. 11/2009, dhe Ligji për zgjedhjet e përgjithshme. Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur fotografat si dëshmi.

PZAP-i, e informoi subjektin politik AAK në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, më datë 12.06.2012, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 13.06.2012, në ora 12:00. Sipas afatit të caktuar në shkresën Nr.169/2, PZAP-i, nuk mori përgjigjen e kërkuar nga subjekti politik AAK.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

## Ankesa është e bazuar

Nga fotografitë e ofruara si provë të cilat gjenden në shkresat e lëndës shihet qartë se panoja e kandidatit për kryetar komune të Kaçanikut Tahir Çaka nga radhët e subjektit politik AAK është e vendosur në kalanë e qytetit, e që është në kundërshtim me nenin 3.1 pika b) të Rregullës Zgjedhore 11/2009 dhe nenin 33 pika b) të LZP-së e cila përcakton veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore, që ndalon vendosjen e plakateve, posterave dhe njoftimeve brenda ose jashtë godinave dhe objekteve publike.

Për përcaktimin e lartësisë së gjobës të vendosur në dispozitiv të këtij vendimi PZAP-i, ka marrë parasysh faktorët në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Andaj, duke marr parasysh se nga ana e subjektit politik AAK është shkelur nen 3 paragrafi 1 pika "b" të Rregullës Zgjedhore 11/2009 dhe nenin 33 pika b) të LZP-së, ngase nga dëshmitë që gjenden në shkresat e lëndës shihet qartë se panoja e kandidatit për kryetar të komunës së Kaçanikut nga radhët e subjektit politik AAK është vendosur në objekt publik, si dhe duke marr parasysh faktorët e cituar më lart për përcaktimin e lartësisë së gjobës, në kuptim të nenit 120 paragrafi 1 pika (c) si dhe nenit 115.1 të LZP-së, PZAP-i vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkuesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetkatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshire është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

### Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa në Prishtinë

Anr. 169/2012 më datën 14.06.2012.

